



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



01Nr.07-104/02-11731/26
Kaçanik, 26.05.2026

PROCESVERBAL

Nga konsultimi publik lidhur me Draft-Rregulloren për Transport Publik për territorin e komunës së Kaçanikut, mbajtur me datë 26.05.2026, e Marte, në sallën e Kuvendit të komunës, me fillim pune në ora 09:00.

Të pranishëm në konsultim publik ishin: Drejtori i DSHPE-së- Arian Teneqja, anëtarët e grupit punues për hartimin e Draft-Rregullore për Transport Publik në komunën e Kaçanikut: Besim Sallahu, Kaltrina Guri. Nga persona të tjere te interesuar: Suhad Dullovi (DBZHRP), Korab Krasniqi (DUKMM), Urata Sopa (DAP), Jehona Dervishi (DUKMM), Arditë Shehu (DUKMM), Hajredin Shehu (DSHPE), Valdrin Dogani (DBF), Arlinda Rakoci-Raka (DZHET), Lumnie Selmanaj (DSHMS), Arben Fera (DSHPE), Fahrije Luzha- Çaka (DBF), Sali Dema, Besim Sallahu (Inspektor), Kaltrina Çaka- Guri (DSHPE).

Takimin e udhëheqi Drejtori i DSHPE-së-së Arian Teneqja.

Procesmbajtëse, Kaltrina Çaka - Guri, zyrtare ligjore në DSHPE.

Drejtori i DSHPE-së Arian Teneqja - Përshëndetje për të gjithë, ju falenderoj për pjesmarrje në këtë debat publik lidhur me Draft-Rregulloren për Transport Publik në territorin e Komunës së Kaçanikut.

Ky draft - rregullore është punuar nga grupi punues: drejtori i mëparshëm Ramadush Osmani, Besim Sallahu, Menduh Krasniqi dhe Kaltrina Çaka-Guri.

Ky draft ka qenë i publikuar në web faqen e komunë nga data 19.05.2026, deri më 26.25.2026.

Po fillojm me diskutimin.

Në këtë rregullore janë intervenuar janë shtuar disa pjesë, por vlenë te ceket se ka edhe nene nga rregullorja e vjetër. Në këtë rregullore janë ndryshuar kushtet për tu pajisur me licence dhe leje për transport publik të udhëtarëve. Gjohat janë ndryshuar për personat fizik dhe juridik, pasta shërbimi merimange e ka edhe ndryshime të tjera.

Nëse keni pyetje diqka urdhëroni.

Valdrin Dogani – kush kujdeset për zbatimin e kësaj rregullore?

Drejtori i DSHPE-së - Arian Teneqja: për zbatimin e kësaj rregullore kujdeset Inspektori i Komunikacionit dhe Policia e Kosovës që është e paraparë në nenin 63-pra mbykqyrja dhe kontrolli.

Fahrije Luzha - Çaka - si kanë qenë me rregullore të vjetër dhe si janë rendet e udhëtimit d.m.th kohëzgjatja si ka qenë dhe si do të jetë me rregullore të re?

Drejtori i DSHPE-së- viteve tjera janë vazhduar për 1 vit, kurse me këtë rregullore rendet e udhëtimit vlejné për 3 vite për autobus, kombi-bus dhe mini-bus.

Operatorët për gjdo vjet kanë ardh dhe i kanë vazhduar, kurse tani për 3 vite i vazhdojn e kryejn pagesen menjëherë.

Ardita Shehu: pse ministria e drejtësis ka dhënë vërejtje te pjesa e gjobave, qka nuk ka qenë në rregull?

Besim Sallahu: ministria e drejtësis ka dhënë vërejtje lidhur me gjobat, ka kërkuar ta bëjmë harmonizimin me ligjin e kundërvatjeve, sepse na ka ikur neve si grup punues, nuk kemi parapar gjobe veq per personat fizik e tjetër gjobe per persona juridic, tani e kemi rregulluar.

Hajredin Shehu: a e keni paraparë mundësin në këtë rregullore që gjitha veturat auto-taxi të kenë të njetën ngjyrë ose të kenë ndonjë shejë që vërehet se është auto taxi?

Drejtori I DSHPE-së- jo në këtë rregullore nuk është e paraparë që veturat auto-taxi të kenë të njetën ngjyrë për shkak të kostos që mund ti shkaktoheshin taksistëve.

Drejtori I DSHPE-së- nëse nuk keni diqka tjetër për diskutim e mbyllim takimin publik.
Debat i përfundoi në ora 10:10.

Procesmbajtëse
Kaltrina Çaka-Guri



Drejtori i DSHPE-së
Arian Teneqja